



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS  
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA  
KOSOVA BAR ASSOCIATION**

Në pajtim me nenet 42. par. 2, nenin 50 dhe 51 të Ligjit për Avokatinë nr. 04/L- 193, lidhur me nenin 87.1.4 të Statutit të OAK-së, Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës në mbledhjen e vet të rregullt, të mbajtur më 26 Qershor 2023, miraton si në vijim:

**Rregullore për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë**

**Dispozitat e përgjithshme**

**Neni 1**

**Qëllimi dhe fushëveprimi**

Me këtë rregullore përcaktohet procedura disiplinore për avokatët dhe praktikantët të regjistruar në OAK, në pajtim me Ligjin për Avokatinë, Statutin, Kodin e e Etikës Profesionale të Avokatit dhe akte tjera normative të OAK-së. Procedura disiplinore zbatohet me qëllim të përcaktimit të përgjegjesisë disiplinore të avokatit apo praktikantit të avokatit.

**Neni 2**

**Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

**OAK** - Oda e Avokatëve të Kosovës.

**Ushtrues të fletëparaqitjes** - personi fizik, juridik dhe organet tjera.

**Procedura disiplinore** - zhvillimi i procedurës disiplinore ndaj avokatit apo praktikantit, kundër të cilit është ushtruar fletëparaqitja disiplinore, hetimi disiplinor, procedimi i propozimit dhe zhvillimin e procedurës disiplinore para Komisionit Disiplinor dhe Komisionit për Ankesa.

**Arsye e bazuar** - posedimi i provave që do të bindte një vëzhgues objektiv se me veprim apo mosveprim avokati apo praktikanti ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuar me aktet normative të OAK-së, për të cilën parashihet masë disiplinore.

**Shkelja Disiplinore** - shkeljet e detyrimeve dhe cënimit të autoritetit të avokatisë të përcaktuara me normativën e OAK-së.

**I paraqituri** - avokati apo praktikanti i avokatit i regjistruar në OAK, ndaj të cilit është ushtruar fletëparaqitje disiplinore apo propozimi për masë disiplinore.

**Masë disiplinore** - Masat e përcaktuara me Ligjin për Avokatinë dhe Statutin e OAK-së.

### **Neni 3 Parimet e Procedurës Disiplinore**

1. I paraqituri ndaj të cilit zhvillohet procedura disiplinore konsiderohet që nuk ka bërë shkelje disiplinore deri në vendimin e të formës së prerë.
2. Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve relevante për çështjen apo për zbatimin e ndonjë dispozite të Ligjit për Avokatinë, Statutin dhe aktet tjera të OAK-së interpretohen në favor të të paraqiturit dhe të drejtave të tij sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
3. Shkeljet dhe masat disiplinore përcaktohen vetëm sipas mënyrës së paraparë me aktet normative të OAK-së. Askujt nuk mund t'i shqiptohet masë disiplinore për shkeljet të cilat para kryerjes së tyre nuk janë paraparë si shkelje disiplinore sipas normativës së OAK-së.

### **Neni 4 Organet Disiplinore**

1. Organet Disiplinore, janë si në vijim:
  - 1.1. Zyra e Prokurorit Disiplinor,
  - 1.2. Komisioni Disiplinor,
  - 1.3. Komisioni i Ankesave.

### **Neni 5 Pavarësia e Organeve Disiplinore**

Organet Disiplinore veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.

### **Neni 6 Gjuha dhe përkthimi**

1. Procedura disiplinore nga organet disiplinore zhvillohet në njëren nga gjuhët zyrtare në Kosovë.
2. Palët dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë njoftohen për të drejtën e tyre për t'u deklaruar në gjuhën e vet. Pala që merr pjesë në procedurë disiplinore e cila nuk e njeh gjuhën në të cilën zhvillohet procedura disiplinore njoftohet për të

drejtën e tij në përkthim. Përkthimi i sigurohet përmes një përkthyesi, me shpenzime të OAK-së. Heqja dorë nga kjo e drejtë duhet të konstatohet në procesverbal.

### **Neni 7** **Fillimi i procedurës disiplinore**

1. Çdo kush mund të parashtroj fletëparaqitje disiplinore e cila paraqet bazë për zhvillimin e hetimeve disiplinore ndaj avokatit apo praktikantit të avokatisë.
2. Prokurori Disiplinor mund të filloj hetimet disiplinore edhe sipas detyrës zyrtare.
3. Procedurën disiplinore e fillon Prokurori Disiplinor me ngritjen e propozimit për zhvillimin e Procedurës Disiplinore.

### **Neni 8** **Autorizimet dhe përgjegjësitë e Prokurorit Disiplinor**

Përgjegjësitë, veprimet, autorizimet dhe zgjedhja e Prokurorit Disiplinor rregullohet me Statutin, rregulloren për stafin e OAK-së dhe rregulloren për funksionimin e Zyrës së Prokurorit Disiplinor të OAK-së.

### **Neni 9** **Përgjashtimi i Prokurorit Disiplinor**

1. Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të cilat rregullojnë përgjashtimin e Prokurorit të Shtetit, zbatohen përshtatshëm kur paraqiten rrethanat për përgjashtimin e Prokurorit Disiplinor.
2. Nëse prokurori mëson se ekziston ndonjë arsye për përgjashtim, ndërpret çdo aktivitet lidhur me çështjen dhe për këtë e njofton me shkrim brenda 3 ditësh, Këshillin Drejtues të OAK-së, i cili vendos lidhur me përgjashtimin e tij.
3. Palët në procedurë kanë të drejtë të kërkojnë përgjashtimin e Prokurorit Disiplinor nga përfaqësimi i rastit në procedurë, sapo të ketë mësuar për ekzistimin e arsyeve për përgjashtim. Kërkesën për përgjashtim të Prokurorit Disiplinor pala duhet të paraqes me shkrim së paku 3 (tre) ditë para seancës.
4. Përgjashtimisht, për shkaqet e mësuara më vonë, pala mund ta paraqes gjatë seancës kërkesën për përgjashtimin e Prokurorit Disiplinor.
5. Kryetari i Kolegjit Disiplinor e urdhëron palën që kërkesën nga paragrafi 4 ta paraqes me shkrim në afat prej 3 (tre) ditësh, në të kundërtën konsiderohet se ka heqë dorë nga kërkesa.
6. Kryetari i Kolegjit Disiplinor brenda afatit prej 3 (tre) ditësh do t'ia dërgoj Këshillit Drejtues të OAK-së kërkesën për përgjashtim, i cili duhet të vendosë në afatin prej 5 (pesë) ditësh.
7. Nëse aprovohet përgjashtimi i Prokurorit Disiplinor, automatikisht detyrën e tij e merr Kryetari i Komitetit për Etikë Profesionale ose ndonjëri nga anëtarët e Komitetit për Etikë Profesionale.

## **Neni 10**

### **Fletëparaqitja**

1. Fletëparaqitja i drejtohet Zyrës së Prokurorit Disiplinor të OAK-së dhe e njëjta përmban:
  - 1.1. Emrin, mbiemrin, adresën, numrin e telefonit të personit që ushtron fletëparaqitjen;
  - 1.2. Emrin dhe mbiemrin e avokatit apo praktikantit të paraqitur;
  - 1.3. Përshkrimin e kohës, vendit dhe mënyrës së shkeljes së pretenduar disiplinore si dhe provat që mbështesin bazën për fillim të Procedurës Disiplinore.

## **Neni 11**

### **Shqyrtimi Paraprak nga Zyra e Prokurorit Disiplinor**

1. Zyra e Prokurorit Disiplinor sipas fletëparaqitjes së paraqitur do të kryej veprimet hetimore të nevojshme dhe pas kësaj:
  - 1.1. Me vendim do ta hedhë poshtë fletëparaqitjen brenda afatit prej 60 ditësh, nëse konkludon se veprimet e paraqitura nuk kanë elemente të shkeljes disiplinore ose për shkak të arritjes së parashkrimit të shkeljes dhe të zhvillimit të procedurës disiplinore;
  - 1.2. Nëse brenda afatit prej 60 dite nuk është hudhur fletëparaqitja konsiderohet që kanë filluar hetimet disiplinore.
  - 1.3. Do të përpilojë propozimin për zhvillimin e procedurës disiplinore për shkeljen disiplinore dhe të njejtën e përfaqëson;
  - 1.4. Kundër vendimit për hedhje poshtë të fletëparaqitjes disiplinore, paraqitësi i fletëparaqitjes ka të drejtë kundërshtimi, nëpërmjet Prokurorit Disiplinor të Odës, në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Kundërshtimi i dërgohet të paraqiturit i cili ka të drejtë që të paraqet përgjigje në kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditë;
  - 1.5. Lidhur me kundërshtimin për hedhje të fletëparaqitjes, përfundimisht vendos Komisioni I Ankesave i Odës së Avokatëve të Kosovës.
2. Zyra e Prokurorit Disiplinor pas pranimit të fletëparaqitjes njofton të paraqiturin lidhur me fillimin e hetimit disiplinor dhe kërkon përgjigje me shkrim në lidhje me pretendimet e fletëparaqitjes në afatin prej 8 ditëve.

## **Neni 12**

### **Hetimi Disiplinor**

1. Zyra e Prokurorit Disiplinor ka kompetenca për kërkimin dhe marrjen e dëshmive nga subjektet që mund të jenë në dijeni për faktet e nevojshme lidhur me çështjen që është objekt i hetimit disiplinor.
2. Çdo anëtar i OAK-së obligohet që në afatin prej 15 ditësh të ofroj dëshmi në cilësinë e dëshmitarit sipas kërkesës nga Zyra e Prokurorit Disiplinor.

### **Neni 13**

#### **Propozimi për fillimin e procedurës disiplinore**

1. Zyra e Prokurorit Disiplinor përgatitë propozim dhe të njëjtin ia dërgon Komisionit Disiplinor.
2. Propozimi përfshin:
  - 2.1. Emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit të parashtruesit të fletëparaqitjes;
  - 2.2. Emrin, mbiemrin, adresën, numrin e licencës të të paraqiturit;
  - 2.3. Emërtimin e shkeljes disiplinore duke iu referuar Statutit, Kodit Etik dhe akteve tjera normative të OAK-së;
  - 2.4. Përshkrimin e kohës, vendit dhe mënyrës së shkeljes së pretenduar disiplinore;
  - 2.5. Shpjegimin e arsyeve për paraqitjen e propozimit bazuar në rezultatet e hetimit dhe provat që vërtetojnë faktet kryesore;
  - 2.6. Rekomandimin e Zyrës së Prokurorit Disiplinor lidhur me ekzistimin e arsyes së bazuar.
3. Në rastet kur propozimi i Zyrës së Prokurorit Disiplinor nuk është i përpiluar sipas kushteve të përcaktuara nga paragrafi 2 (dy) i këtij neni, Komisioni Disiplinor e kthen propozimin në plotësim Zyrës së Prokurorit Disiplinor, që në afat prej 15 ditësh të njëjtin ta plotësoj ose korrigjoj për procedim të mëtejshëm.
4. Në rast se Zyra e Prokurorit Disiplinor nuk e plotëson propozimin sipas paragrafit 3 (tre), Komisioni Disiplinor me aktvendim e hedhë propozimin, kundër të cilit nuk lejohet ankesë.
5. Një kopje e aktvendimit i dërgohet Këshillit Drejtues të OAK-së.

### **Neni 14**

#### **Marrëveshja për pranimin e përgjegjesisë disiplinore**

1. Në çdo fazë të Procedurës Disiplinore, Prokurori Disiplinor dhe i paraqituri mund të negociojnë dhe arrijnë marrëveshje për pranimin e përgjegjesisë disiplinore.
2. Marrëveshja përmban:
  - 2.1. Pranimin e përgjegjesisë për shkeljen disiplinore;
  - 2.2. Masën disiplinore dhe lartësinë apo kohëzgjatjen e saj;
3. Marrëveshja duhet të nënshkruhet nga i paraqituri, Prokurori Disiplinor dhe e njëjta i dërgohet Komisioni Disiplinor për vendosje.
4. Lidhur me marrëveshjen për pranimin e përgjegjesisë disiplinore njoftohet fletëparaqitësi.

### **Neni 15**

#### **Komisioni Disiplinor**

Komisioni Disiplinor pas pranimit të propozimit nga Zyra e Prokurorit Disiplinor të OAK-së është përgjegjës për udhëheqjen e procedurës disiplinore kundër të paraqiturit për shkelje disiplinore.

## **Neni 16**

### **Kolegji Disiplinor**

Kryetari i Komisionit Disiplinor cakton Kolegjin Disiplinor, i cili përbëhet prej tre (3) anëtarëve, brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i propozimit, ku e cakton edhe kryesuesin.

## **Neni 17**

### **Përfashtimi i kryetarit apo anëtarit të kolegjit**

1. Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të cilat rregullojnë përfashtimin e gjyqtarit, zbatohen përshtatshëmish t kur paraqiten rrethanat për përfashtimin e kryetarit apo anëtarit të kolegjit.
2. Nëse kryetari apo anëtari i kolegjit mëson se ekziston ndonjë arsye për përfashtim, ndërpret çdo aktivitet lidhur me çështjen dhe për këtë e njofton me shkrim brenda 3 (tre) ditësh, Kryetarin e Komisionit Disiplinor, i cili cakton zëvendësimin e tij.
3. Palët në procedurë kanë të drejtë të kërkojnë përfashtimin e anëtarit të kolegjit, sapo të kenë mësuar për ekzistimin e arsyeve për përfashtim. Kërkesën për përfashtim të anëtarit të kolegjit, pala duhet të paraqes me shkrim së paku 3 (tre) ditë para seancës.
4. Përfashtimisht, për shkaqet e mësuar më vonë, pala mund ta paraqes kërkesën për përfashtimin e kryetarit apo anëtarit të kolegjit gjatë seancës.
5. Nëse kërkesa paraqitet gjatë seancës, kryetari i Kolegjit Disiplinor e urdhëron palën që kërkesën nga paragrafi 4 ta paraqes në afat prej 3 (tre) ditësh, në të kundërtën konsiderohet se ka heqë dorë nga kërkesa.
6. Kryetari i Kolegjit Disiplinor lidhur me kërkesën si në paragrafin 3 (tre) dhe 4 (katër), njofton kryetarin e komisionit i cili duhet të vendosë në afatin prej 5 (pesë) ditësh.
7. Për përfashtimin e Kryetarit të Komisionit Disiplinor, përshtatshëmish t sipas paragrafëve 3, 4 dhe 5 vendos Kryetari i Komisionit të Ankesave.
8. Për përfashtimin e anëtareve të Komisionit për Ankesa vendosë kryetari i Komisionit të Ankesave.
9. Për kërkesën për përfashtimin e Kryetarit të Komisionit për Ankesa vendosin anëtarët e tjerë të komisionit.

## **Neni 18**

### **Shqyrtimi paraprak i Propozimit nga Kolegjit Disiplinor**

1. Pas marrjes së lëndës në shqyrtim, Kolegji Disiplinor në afat prej shtatë (7) ditësh e hedhë propozimin e Prokurorit Disiplinor dhe pushon procedurën nëse vlerëson se:
  - 1.1. Nga shkresat e lëndës nuk rezulton se kemi të bëjmë me shkelje disiplinore;
  - 1.2. Ekzistojnë rrethanat që përfashtojnë përgjegjësinë disiplinore;
  - 1.3. Ekziston vendimi i formës së prerë për të njëjtën çështje; ose

- 1.4. Ka arritur afati i parashkrimit për zhvillimin e Procedurës Disiplinore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankesa në afat prej tetë (8) ditësh, për Komisionin për Ankesa.
3. Në rastet kur kolegji vlerëson se ka arsye të bazuar, vendos për zhvillimin e procedurës disiplinore dhe cakton shqyrtimin kryesor.

### **Neni 19** **Përgatitja për seancën disiplinore**

1. Kryetari i kolegjit cakton ditën, orën dhe vendin e mbajtjes së seancës disiplinore.
2. Të paraqiturit i dërgohet thirrja në letër të mbyllur e cila përfshin: emrin dhe mbiemrin e të paraqiturit; emrin dhe mbiemrin e paraqitësit; vendin, ditën dhe orën kur duhet të paraqitet I paraqituri; njoftimin se thirret në cilësi të të paraqiturit.
3. I paraqituri, në thirrje udhëzohet për të drejtën e tij për të angazhuar avokat.
4. Së bashku me thirrje, të paraqiturit i dërgohet edhe propozimi për fillimin procedurës si dhe provat të cilat i bashkëngjiten propozimit;
5. Nëse i paraqituri ose avokati i tij të ftuar në mënyrë të rregullt, nuk marrin pjesë në seancë dhe nuk arsyetojnë mungesën, seanca kryesore do të mbahet në mungesë të tyre.

### **Neni 20** **Ftesa**

Pjesëmarrësit në Procedurë Disiplinore, ftohen së paku 8 (tetë) ditë para seancës kryesore disiplinore.

### **Neni 21** **Seanca kryesore**

1. Seanca kryesore mbahet në zyrën e OAK-së në Prishtinë.
2. Përjashtimisht, Kolegji Disiplinor, me pajtimin e Kryetarit të Komisionit Disiplinor, mund të vendosë që seanca kryesore të mbahet jashtë zyrës të OAK-së, nëse përmes këtij veprimi sigurohet prania e palëve, dëshmitarëve dhe e ekspertëve ose nëse grumbullimi i dëshmitarëve apo provave për lëndën është më i lehtë.
3. Kryetari i Kolegjit Disiplinor mund të shtyjë datën e seancës kryesore nëse këtë e propozojnë palët apo nëse nuk janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës.

### **Neni 22** **Pjesëmarrësit në seancën kryesore**

1. Seanca kryesore mbahet pa praninë e publikut.

2. Me lejen e Kryetarit të Kolegjit, në seancën kryesore mund të marrin pjesë: praktikantët, studentët e fakultetit juridik, pjesëmarrësit për nevoja të punimeve shkencore.
3. Pjesëmarrësit e seancës disiplinore duhet të ruajnë fshehtësinë e procedurës disiplinore.

### **Neni 23**

#### **Procesverbali i seancës kryesore**

1. Për seancën kryesore mbahet procesverbali me shkrim.
2. Me propozim të palëve, nëse ekzistojnë kushtet, Kryetari i Kolegjit Disiplinor mund të urdhërojë audio incizimin si dhe transkriptimin.
3. Procesverbali nënshkruhet nga palët, Kryetari i Kolegjit Disiplinor dhe procesmbajtësi.

### **Neni 24**

#### **Hapja e Seancës kryesore**

1. Kryetari i Kolegjit Disiplinor hap seancën kryesore dhe i informon të pranishmit për përbërjen e kolegjit dhe palët në procedurë.
2. Kryetari i kolegjit konstaton nëse të gjithë personat janë ftuar në mënyrë të rregullt, nëse personat e ftuar janë të pranishëm në seancën kryesore dhe nëse nuk kanë ardhur, verifikon se a i kanë arsyetuar mungesat e tyre.

### **Neni 25**

#### **Udhëzimet për të paraqiturin**

1. Pasi që Kryetari i Kolegjit Disiplinor të konstatoj se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës, njofton të paraqiturin për të drejtat e tij, se:
  - 1.1. ka të drejtë të mos deklarohet për rastin e tij apo që të mos përgjigjet në asnjërën prej pyetjeve;
  - 1.2. ka të drejtë dhe i lejohet të jep deklaratë për të gjitha faktet dhe dëshmitë kundër tij dhe të deklaroj faktet dhe dëshmitë që janë në favor të tij;
  - 1.3. ka të drejtë që t'iu parashtroj pyetje dëshmitarëve, që t'i udhëzojë të tjerët ta bëjnë një gjë të tillë, si dhe të sigurojë pjesëmarrjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij sipas kushteve të njëjta sikurse për dëshmitarët kundër tij;
  - 1.4. nëse deklarohet, atëherë nuk obligohet ta ngarkoj vetveten apo të pranojë përgjegjësinë;
  - 1.5. mund të mbrojë vetën personalisht apo përmes ndihmës juridike të avokatit sipas zgjedhjes së tij;
  - 1.6. ka të drejtë në përkthim falas, nëse nuk e flet gjuhën në të cilën zbatohet Procedura Disiplinore.
2. Kryetari i Kolegjit Disiplinor, udhëzon të paraqiturin që të përcjellë me vëmendje seancën disiplinore dhe se mund të paraqes fakte, t'u parashtrojë pyetje



dëshmitarëve dhe ekspertëve, si dhe të bëj vërejtje dhe të jap shpjegime rreth deklarimeve të tyre.

3. Kryetari i Kolegjit Disiplinor fton përfaqësuesin e Zyrës së Prokurorit Disiplinor që t'a lexoj propozimin për procedurën disiplinore.

#### **Neni 26**

#### **Deklarimi i të paraqiturit lidhur me Propozimin Disiplinor**

1. Kryetari i Kolegjit Disiplinor e pyet të paraqiturin se a e ka kuptuar Propozimin e Prokurorit Disiplinor, dhe pasi që i njëjti të bindet se i paraqituri e ka kuptuar propozimin e tillë, e fton të paraqiturin të deklarohe se e pranon apo nuk e pranon përgjegjësinë disiplinore.
2. Kur i paraqituri nuk dëshiron të deklarohe lidhur me përgjegjësinë e tij disiplinore, konsiderohet se nuk e pranon përgjegjësinë.
3. Kur i paraqituri e pranon përgjegjësinë disiplinore Kolegji Disiplinor i fton palët që të paraqesin fjalën përfundimtare.

#### **Neni 27**

#### **Mos prezenca në seancën kryesore**

1. Nëse Prokurori Disiplinor nuk paraqitet në seancë dhe mungesën nuk e arsyeton, Kolegji Disiplinor merr vendim për shtyrjen e seancës dhe e njofton Drejtorin Ekzekutiv të OAK-së.
2. Nëse i paraqituri nuk paraqitet në seancë dhe nuk e arsyeton mungesën e tij, seanca kryesore mbahet pa praninë e tij.
3. Nëse i paraqituri paraqitet në seancë, por avokati i tij mungon edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt, dhe nuk jep arsyetim për këtë mungesë ose kur avokati del nga seanca kryesore pa lejen e kolegjit, seanca kryesore do të mbahet pa praninë e tij.
4. Nëse dëshmitarët apo ekspertët nuk paraqiten dhe nuk japin arsyetim për këtë mosparaqitje edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt, seanca kryesore mund të mbahet pa praninë e tyre, nëse palët pajtohen.
5. Nëse palët nuk pajtohen, shtyhet seanca dhe palët detyrohen që të kujdesen për sigurimin e prezencës së tyre në seancën e radhës.
6. Sipas propozimit të palëve apo kur Kolegji Disiplinor e vlerëson të nevojshme mund të bëhet leximi i deklaratave të dëshmitarëve ose mendimeve të ekspertëve.

#### **Neni 28**

#### **Mbajtja e rendit gjatë seancës kryesore**

1. Kryetari i Kolegjit Disiplinor përkujdeset për mbajtjen e rendit gjatë seancës.
2. Menjëherë pas hapjes i njofton të pranishmit që të sillen në mënyrë të duhur dhe që të mos pengojnë punën e Kolegjit Disiplinor.

3. Nëse ndonjë i pranishëm e shkel rendin, pas tërheqjes së vërejtjes së parë dhe vërejtjes së dytë, kolegji mund ti shqiptojë gjobë deri në 250,00 euro.
4. Kolegji Disiplinor mund të përjashtojë të paraqiturin apo avokatin e tij nga seanca, nëse edhe pas vërejtjes dhe dënimit si me lartë, të njëjtit vazhdojnë të prishin rendin.
5. Për veprimet nga paragrafi 4 i këtij neni, njoftohet Zyra e Prokurorit Disiplinor për qëllime të hetimit të shkeljes disiplinore.
6. Nëse Prokurori Disiplinor prish rendin, kryetari i kolegjit e ndërprejnë seancën dhe ai menjëherë njofton Drejtorin Ekzekutiv të OAK-së.

### **Neni 29**

#### **Radhitja e prezantimit të provave**

1. Radhitja e provave përfshinë të gjitha provat dhe faktet që kolegji i konsideron të rëndësishme për marrjen e vendimit në mënyrë të drejtë dhe të duhur.
2. Si rregull, provat e propozuara nga Prokurori Disiplinor paraqiten të parat, pastaj provat nga i paraqituri apo përfaqësuesi i tij dhe në fund paraqiten provat për të cilat kolegji ka vendosur që të merren sipas vlerësimit të kolegjit.
3. Deri në fjalën përmbyllëse, palët mund të propozojnë prova dhe fakte të reja.
4. Në vendimin e Kolegjit Disiplinor me të cilin është vendosur të nxirren ose të refuzohen provat e propozuara, palët nuk kanë të drejtë në ankesë të veçantë.

### **Neni 30**

#### **Marrja në pyetje e dëshmitarëve**

1. Para marrjes në pyetje së dëshmitarit, Kryetari i Kolegjit e njofton dëshmitarin për detyrimin e tij për të treguar të vërtetën dhe për pasojat ligjore që bart dëshmia e rrejshme sipas KPRK-së.
2. Kolegji Disiplinor mund të kërkojë nga dëshmitari që të bëjë betimin. Betimi I dëshmitarit është si në vijim: "Duke qenë i/e vetëdijshëm/me për rëndësinë e dëshmisë dhe për përgjegjësinë time ligjore, betohem solemnisht se do të tregoj të vërtetën, vetëm të vërtetën dhe asgjë përveç të vërtetës, dhe se nuk do të fsheh asgjë, për të cilën kam njohuri".
3. Gjatës seancës palët kanë të drejtën e parashtrimit të pyetjeve dëshmitarit.
4. Pala e parë që do të parashtron pyetjet do të jetë pala propozuese, pastaj pala e kundërt dhe Kolegji Disiplinor.

### **Neni 31**

#### **Marrja në pyetje e ekspertëve**

1. Eksperti, konstatimin dhe mendimin e tij e jep në formë të shkruar.
2. Kolegji Disiplinor mund ta ftojë ekspertin të jap sqarime dhe plotësime në seancë disiplinore, nëse për këtë propozojnë palët në procedurë ose për këtë vlerëson Kolegji Disiplinor.

3. Para fillimit të marrjes në pyetje të ekspertit, kryesuesi i kolegjit mund të kërkojë që të bëjë betimin. Betimi i ekspertit është si në vijim: Duke qenë i/e vetëdijshëm/me për rëndësinë e dëshmisë dhe për përgjegjësinë time ligjore, betohem solemnisht se do të zbatojë analizën time të ekspertit me ndërgjegje dhe ashtu si di më së miri, si dhe do të deklarojë konstatimet dhe mendimin tim në mënyrë të saktë dhe të plotë”.
4. Gjatës seancës palët kanë të drejtën e parashtrimit të pyetjeve ekspertit.
5. Pala e parë që do të parashtron pyetjet do të jetë pala propozuese, pastaj pala e kundërt dhe Kolegji Disiplinor.

### **Neni 32** **Mbrojtja e të paraqiturit**

1. I paraqituri merret në pyetje pas administrimit të provave. Gjatë deklaramit të tij mund t'i lejohet t'i shfrytëzojë shënimet në mbështetje të mbrojtjes së tij.
2. Marrja në pyetje e të paraqiturit bëhet duke e respektuar dinjitetin e tij.
3. Të paraqiturin, i pari e merr në pyetje avokati i tij, pastaj Prokurori Disiplinor, ushtruesi I fletëparaqitjes, dhe në fund Kolegji Disiplinor.
4. Të paraqiturit pyetjet i parashtrohen në mënyrë të qartë dhe të saktë.

### **Neni 33** **Fjala Përfundimtare e Palëve**

1. Pas përfundimit të procedurës së provave, kryesuesi i kolegjit fton palët të paraqesin fjalën përfundimtare. Prokurori Disiplinor deklarohet i pari, pastaj ushtruesi i fletëparaqitjes, avokati i të paraqiturit dhe i paraqituri.
2. Paraqitja e fjalës përfundimtare nga palët mund të kufizohet në kohë nga Kryetari i Kolegjit Disiplinor për çështjet jo relevante.
3. Në fjalën përfundimtare, palët mund të paraqesin vlerësimin e tyre për provat e administruara në seancën kryesore, dhe të shpjegojnë përfundimet e tyre lidhur me faktet e rëndësishme për vendimin, si dhe të paraqesin dhe arsyetojnë propozimet e tyre lidhur me përgjegjësinë disiplinore të të paraqiturit, si dhe të propozojnë rrethana lehtësuese apo rënduese që duhet të merren parasysh gjatë shqiptimit të masës disiplinore nga kolegji.
4. Palët në procedurë fjalën përfundimtare mund ta paraqesin në formë të shkruar.
5. I paraqituri gjithmonë në fjalën përfundimtare deklarohet i fundit.
6. Pas fjalës përfundimtare të palëve, kryetari i kolegjit e shpall seancën disiplinore të përfunduar.

### **Neni 34** **Seanca për këshillim dhe votim**

1. Kolegji Disiplinor merr vendim pas shqyrtimit dhe votimit në seancë.
2. Kolegji Disiplinor bazon vendimin e vet vetëm në fakte dhe dëshmi të shqyrtuara gjatë seancës disiplinore.

3. Kolegji është i obliguar të bëjë vlerësim të drejtë të çdo prove veç e veç dhe të gjitha në tërësi apo në ndërlidhje me njëra tjetrën ashtu që të marr vendimin e drejtë.
4. Gjatë marrjes së vendimit për çështjen kryesore, së pari votohet nëse i paraqituri ka përgjegjësi disiplinore, natyrën e shkeljes, masën disiplinore, shpenzimet e procedurës dhe paushallin financiar të procedurës disiplinore.
5. Kolegji Disiplinor mban procesverbalin për këshillim dhe të votim, ky procesverbal përmban:
  - 5.1. faktet e shqyrtuara nga kolegji me rastin e nxjerrjes së vendimit dhe cilat janë konsideruar si të vërtetuara dhe cilat si të pavërtetuara, nëse ka pasur të tilla;
  - 5.2. masat disiplinore që kolegji disiplinor i konsideron si të duhura.
  - 5.3. konstatimin nëse vendimi është marrë njëzëri apo nëse ka pasur mendime të ndryshme nga cilido prej anëtarëve të kolegjit;
  - 5.4. vendimin e kolegjit për shpenzimet procedurale dhe paushallin financiar të procedurës disiplinore.
6. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e kolegjit, futet në zarfin e mbyllur dhe mbahet në dosjen e lëndës.

### **Neni 35** **Vendimi me shkrim**

1. Vendimin me shkrim e harton kryetari i kolegjit dhe nënshkruhet nga Kryetari i Kolegjit Disiplinor dhe procesmbajtësi.
2. Vendimi me shkrim duhet të jetë në përputhje me vendimin e marr në seancën e këshillimit dhe votimit dhe i njëjti duhet të përpilohet në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas përfundimit të seancës kryesore.
  - 2.1. Vendimi përmban hyrjen, dispozitivin, arsyetimin dhe këshillën juridike.
    - a) Hyrja përfshin: emërtimin e institucionit, organit që merr vendimin; emrin dhe mbiemrin e kryetarit, dhe të anëtarëve të Kolegjit Disiplinor dhe të procesmbajtësit; emrin dhe mbiemrin e të paraqiturit, të dhënat e propozimit për masë disiplinore; emrin dhe mbiemrin e përfaqësuesit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor, të ushtruesit të fletëparaqitjes, të avokatit të të paraqiturit, dhe datën e marrjes së vendimit.
    - b) Dispozitivi i vendimit përmban të dhënat personale të të paraqiturit: emrin dhe mbiemrin, numrin e licencës, përshkrimin e veprimeve që konsiderohen shkelje disiplinore dhe kualifikimin juridik të shkeljes disiplinore, vendimin për shpalljen përgjegjës dhe masës disiplinore, vendimin për shpenzimet procedurale dhe të paushallit financiar të procedurës disiplinore apo vendimin për lirim nga përgjegjësia disiplinore dhe publikimin e vendimit disiplinor.
    - c) Në rast të disa shkeljeve për të cilat i paraqituri shpallet përgjegjës, në dispozitivin e vendimit, Kolegji Disiplinor cakton masat për secilën shkelje veç e veç dhe pastaj shqipton masën unike disiplinore.

- 2.2. Në arsyetim e vendimit paraqet arsyjet për çdo pikë veç e veç të vendimit.
3. Nëse të paraqiturit i shqiptohet masa disiplinore e pezullimit apo humbjes së të drejtës së ushtrimit të profesionit të avokatit me vendimin e formës së prerë njoftohen Gjykatat, Prokuroritë dhe institucionet tjera relevante në Republikën e Kosovës.

### **Neni 36** **Shpenzimet e procedurës dhe paushalli**

1. Nëse i paraqituri shpallet përgjegjës i njejtë detyrohet në pagesën e shpenzimeve të procedurës disiplinore dhe paushallit.
2. Nëse i paraqituri nuk shpallet përgjegjës shpenzimet bien në barrë të buxhetit të OAK-së.
3. Shpenzimet e procedurës përbëhen nga:
  - shpenzimet për anëtarët e Kolegjit Disiplinor,
  - shpenzimet për ekspert,
  - shpenzimet për dëshmitarë,
  - shpenzimet për përkthyes/interpretues.

### **Neni 37** **Komisioni për Ankesa**

Komisioni për Ankesa në cilësinë e organit të shkallës së dytë vendos lidhur me ankesat që parashtrihen kundër vendimeve të Kolegjit Disiplinor. Kur komisioni për Ankesa vendos sipas ankesave disiplinore është i detyruar të I përmbahet Ligjit për Avokatinë, Statutit të OAK-së, dhe dispozitave të parapara me këtë rregullore disiplinore.

### **Neni 38** **Ankesa kundër vendimit të Kolegjit Disiplinor**

1. Kundër vendimit të Kolegjit Disiplinor, palët kanë të drejtë ankese në afat prej 8 (tetë) ditë nga data e pranimit të vendimit.
2. Ankesa i drejtohet Kolegjit Disiplinor, për komisionin e ankesave në kopje të mjaftueshme për palët në procedurë.

### **Neni 39** **Ankesa**

1. Ankesa përmban:
  - 1.1. emrin e organit të cilit i drejtohet;
  - 1.2. të dhënat e paraqitësit të ankesës;
  - 1.3. të dhënat e vendimit të ankimuar;

- 1.4. arsyet dhe bazën juridike për ankesë;
- 1.5. propozimin për anulimin e plotë apo të pjesshëm apo ndryshimin e vendimit të ankimuar dhe
- 1.6. datën e paraqitjes dhe nënshkrimin e ankesës.

#### **Neni 40** **Baza për ankesë**

1. Vendimi i Kolegjit Disiplinor mund të ankimohet për shkak të:
  - 1.1 shkeljes së dispozitave të Procedurës Disiplinore;
  - 1.2 zbatimi të gabuar të drejtës materiale;
  - 1.3 vërtetimit të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike;
  - 1.4 vendimit për llojin, lartësinë dhe kohëzgjatjen e masës disiplinore
  - 1.5 vendimit për shpenzimet e procedurës

#### **Neni 41** **Procedimi i ankesës**

1. Pas pranimit të ankesës, zyrtari përgjegjës i OAK -së e protokollon ankesën.
2. Zyrtari përgjegjës i OAK -së, brenda afatit prej 3 (tri) ditësh, një kopje të ankesës i dërgon palës së kundërshtare, të cilët mund të paraqesin përgjigje në ankesë brenda 8 (tetë) ditësh nga pranimi i kopjes së ankesës.
3. Pas skadimit të këtij afati, zyrtari përgjegjës i OAK -së brenda 5 ditësh, ankesën, përgjigjen në ankesë dhe shkresat tjera të lëndës ia procedon Komisionit për Ankesa.
4. Pas pranimit të shkresave të lëndës, Kryetari i Komisionit për Ankesa, në afate prej 8 ditësh cakton kolegjin prej 3 anëtarësh, nga radha e anëtarëve të Komisionit për Ankesa, njërin nga të cilët e cakton kryetar të kolegjit, për shqyrtimin e ankesës disiplinore.

#### **Neni 42** **Shqyrtimi i ankesës**

1. Komisioni për Ankesa vendos:
  - 1.1. Në seanca të mbyllura apo
  - 1.2. Në seancë dëgjimore.

#### **Neni 43** **Seancat e mbyllura**

Ankesat kryesisht shqyrtohen në seanca të mbyllura, përveç në rastet kur anëtarët e Kolegjit për Ankesa apo sipas propozimit të palëve e vlerësojnë të arsyeshme se, për sqarimin e çështjes disiplinore ka nevojë të organizohet seanca dëgjimore në praninë e palëve.

**Neni 44**  
**Seancat dëgjimore**

Në rastet e seancave dëgjimore para Kolegjit për Ankesa, zbatohen përshtatshëm rregullat dispozitat e kësaj Rregulloreje.

**Neni 45**  
**Vendimi sipas ankesës**

1. Kolegji për Ankesa në seancë të mbyllur apo në seancë dëgjimore mund të:
  - 1.1.hedh poshtë ankesën si të paafatshme apo të palejueshme;
  - 1.2.refuzojë ankesën si të pabazuar dhe të vërtetojë vendimin e shkallës së parë;
  - 1.3.aprovojë ankesën dhe të ndryshojë vendimin e ankimuar.
  - 1.4.të anulojë vendimin dhe ta kthejë rastin në shkallën e parë për rivendosje.
2. Nëse Kolegji Disiplinor merr cilindo nga vendimet e parapara si në paragrafin 1 në paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij neni, vendimi i Kolegjit për Ankesa është i formës së prerë.
3. Nëse kolegji një herë e ka kthyer çështjen në rishqyrtim në shkallë të parë, herëne dytë do të vendos vet me aktvendim merititor.

**Neni 46**  
**Hedhja e ankesave të paafatshme**

Kolegji për Ankesa me aktvendim e hedh ankesën si të paafatshme kur konstaton se është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor.

**Neni 47**  
**Hedhja e ankesës së palejueshme**

Kolegji për Ankesa me aktvendim e hedh ankesën si të palejueshme kur konstaton se është paraqitur nga personi pa të drejtë ankese ose nga personi që ka hequr dorë nga ankesa.

**Neni 48**  
**Refuzimi i ankesës së pabazë dhe vërtetimi i vendimit të Kolegjit Disiplinor**

Kolegji për Ankesa me aktvendim refuzon ankesën si të pabazë dhe vërteton vendimin e Kolegjit Disiplinor kur vërteton se nuk ekzistojnë shkaqet për të cilat është ushtruar ankesë ndaj vendimit dhe nuk ka shkelje të akteve juridike të OAK-së.

#### **Neni 49**

### **Anulimi i vendimit të Kolegjit Disiplinor dhe kthimi në rivendosje**

1. Kolegji për Ankesa, në raste të caktuara, anulon vendimin e Kolegjit Disiplinor dhe çështjen e kthen në rivendosje kur vërtetohet se:
  - 1.1.ekziston shkelje të dispozitave të procedurës disiplinore dhe Kolegji për Ankesa nuk mund të procedojë sipas nenit 51 të kësaj Rregulloreje; ose
  - 1.2.për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike duhet urdhëruar seancë të re dëgjimore para Kolegjit Disiplinor dhe Kolegji për Ankesa nuk mund të procedojë sipas nenit 51 të kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 50**

### **Ndryshimi i vendimit të kolegjit disiplinor**

1. Kolegji për Ankesa e ndryshon vendimin e Kolegjit Disiplinor me aktvendim kur vërtetohet se Kolegji Disiplinor ka bërë vërtetim të gabuar apo jo të plotë të fakteve, dhe për këtë qëllim:
  - 1.1.në bazë të kërkesës së palëve ose sipas detyrës zyrtare, zbaton seancë dëgjimore për të marrë prova të reja apo për të përsëritur shqyrtimin e provave në mënyrë që të vlerësojë drejtë dhe të çmojë provat materiale; ose
  - 1.2.mund të vërtetojë dhe të çmojë provat materiale pa mbajtur shqyrtim, nëse nuk ka nevojë për të marrë prova të reja apo për të përsëritur shqyrtimin e provave.

#### **Neni 51**

### **Arsyetimi i Vendimeve të Kolegjit për Ankesa**

1. Kolegji për Ankesa në arsyetimin e vendimit vlerëson pretendimet ankimore dhe konstaton nëse ka gjetur shkelje gjatë shqyrtimit të ankesës.
2. Nëse Kolegji për Ankesa e refuzon ankesën dhe e vërtetohet vendimin e Kolegjit Disiplinor, i argumenton shkaqet e refuzimit dhe i sqaron pretendimet ankimore.
3. Kur vendimi i Kolegjit Disiplinor anulohet për shkak të shkeljeve të rregullave të Procedurës Disiplinore, në arsyetim shënohen dispozitat e shkelura dhe në çka konsistojnë shkeljet.
4. Nëse vendimi anulohet për arsye të vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, në arsyetim konstatohen lëshimet për vërtetimin e fakteve, dhe jepen udhëzime konkrete se si duhet vepruar.

#### **Neni 52**

### **REFORMATIO IN PEIUS**

Kur ankesa është paraqitur vetëm nga i paraqituri, Kolegji për Ankesa gjithmonë e merr parasysh parimin juridik REFORMATIO IN PEIUS.



### **Neni 53**

#### **Procedura në Kolegjin Disiplinor pas kthimit të lëndës në rishqyrtim**

1. Gjatë rishqyrtimit, Kolegji disiplinor vepron në bazë të propozimit disiplinor, duke i respektuar udhëzimet e Kolegjit për ankesa.
2. Palët kanë të drejtë që të paraqesin fakte dhe dëshmi të reja gjatë seancës së re dëgjimore.

### **Neni 54**

#### **Mbrojtja gjyqësore**

Kundër vendimit të shkallës së dytë në përkatësisht përfundimtar, me të cilin është shqiptuar masa disiplinore mund të hapet konflikti administrativ në Gjykatën kompetente vetëm për rastet e përcaktuara me Ligjin për Avokatinë.

### **Neni 55**

#### **Plotëfuqishmëria dhe publikimi i vendimeve**

Vendimet përfundimtare të organeve disiplinore të OAK-së marrin vulën e plotëfuqishmërisë dhe vulën e ekzekutueshmërisë. Vendimet përfundimtare publikohen në faqen zyrtare të OAK-së dhe revistën "Avokati Kosovar", duke i anonimizuar të dhënat personale të palëve.

### **Neni 56**

#### **Shlyerja nga evidenca disiplinore**

1. Vendimi me të cilin është caktuar masa disiplinore shlyhet nga dosja e avokatit pas kalimit të afatit prej 1(një) viti për shkelje të lehta disiplinore dhe 2 (dy) vite për shkelje të rënda disiplinore që nga plotëfuqishmëria e vendimit.
2. Pavarësisht paragrafit 1 të këtij neni, humbja e të drejtës së ushtrimit të Avokatisë nga ushtrimi i profesionit të avokatit nuk shlyhet nga evidenca disiplinore.

### **Neni 57**

#### **Procedura Disiplinore kundër avokatëve nga shtetet tjera**

Procedura disiplinore kundër avokatëve nga shtetet tjera, që janë regjistruar në regjistrin e avokateve të huaj, zbatohen përshtatshëmrisht dispozitat përkatëse të Ligjit për Avokatinë.

### **DISPOZITAT KALIMTARE DHE HYRJA NË FUQI**

### **Neni 58**

#### **Dispozitat kalimtare**

Procedurat disiplinore të filluara para hyrjes në fuqi të kësaj rregullore zhvillohen sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

**Neni 59**  
**Hyrja në fuqi**

Plotësimet dhe ndryshimet e kësaj rregulloreje hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës dhe zbatohet nga ajo datë.

**Prishtinë, 26.06.2023**

**Avokat Behar Ejupi, Kryetar**  
**Oda e Avokatëve të Kosovës**